

KOMUNA E PRISHTINËS 2017: PROBLEMET KRYESORE DHE TRENDET BUXHETORE

Hyrje

Komuna e Prishtina udhëhiqet nga Shpend Ahmeti i cili përfaqëson subjektin politik Vetëvendosje. Ky është mandati i tij i parë si kryetar i komunës.

Në zgjedhjet e fundit lokale të mbajtura në nëntor 2013, Ahmeti ka fituar në balotazh ndaj Isa Mustafas nga Lidhja Demokratike e Kosovës. Në raundin e parë, Ahmeti ka pasur 27,415 vota (32%) ndërsa Mustafa 36,755 vota (43%). Ndërsa në balotazh Ahmeti ka dal fitues duke siguruar 37,604 vota (52%) ndërsa Mustafa ka pasur 34,994 vota (48%).¹

Hulumtimet tregojnë se qytetarët e Kosovës kanë njohuri të mjaftueshme mbi ndarjen e kompetencave në mes të pushtetit qendror dhe lokal.² Sipas një studimi të UNDP, 88% e qytetarëve të Prishtinës konsiderojnë se komuna mund t'i zgjidhë problemet me të cilat ballafaqohen ata.³ Po i njëjti studim tregon se 80% e qytetarëve janë shprehur të kënaqur me punën e kryetarit Ahmeti, përderisa 40% e qytetarëve kanë konsideruar se fondet publike në komunë menaxhohen siç duhet.⁴

¹ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Rezultatet për Kryetarë Komune 2013. Burimi: <http://bit.ly/1d30foS> (Hapur më 18 qershor 2017) Rezultatet për Balotazh. Burim: <http://bit.ly/2szzr1OU> (Qasur më 18.06.2017)

² Instituti GAP, Adresimi i Përgjegjësishë: Njohuritë e qytetarëve me kompetencat e komunave. Maj 2017. Burimi: <http://bit.ly/2os7GPU>

³ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim - UNDP, Mozaiku i Kosovës 2015, faqe 37. Burim: <http://bit.ly/2wkuTnr>

⁴ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim - UNDP, Mozaiku i Kosovës 2015, faqe 91 & 92. Burim: <http://bit.ly/2wkuTnr>

Raporti i fundit i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm te pjesa e buxhetit konstaton se ekzekutimi i buxhetit në investime kapitale dhe subvencione nuk është në nivelin e duhur, ndërkohë që një pjesë e suficitit ishte jashtë kontrollit të komunës. Kjo ka ndodhur për shkak që komuna kishte planifikuar shuma të hyrash që nuk ishin inkasuar sipas parashikimeve.⁵

Në prag të zgjedhjeve lokale 2013, Instituti GAP kishte identifikuar problemet kryesore të Komunës së Prishtinës. Ndër problemet më madhore kishin dalë të jenë: mos regjistrimi (përkthimi) i pronave private, transporti urban, mungesa e ujit të pijes, ndërtimet pa leje, uzurpimi i pronave publike, mungesa e vend parkingjeve për vetura, mungesa e çerdheve neper lagjet e qytetit, mungesa e gjelbërimit, mungesa e fushave sportive dhe rekreative, mungesa e ndriçimit publik, mungesa e një qendre për grumbullimin e pemëve dhe perimeve në zonat malore, mungesa e investimeve në lagjen "Dardania", mungesa e nënkalimeve në qytet si dhe mos publikimi i raporteve të shpenzimeve financiare.⁶

Problemet aktuale të Komunës së Prishtinës

Shkatërrimi i objektit të shkollës së skijimit në Brezovicë:


Komuna e Prishtinës përmes ndërmarrjes lokale "Sport Marketing," menaxhon me dy hapësira relativisht të mëdha, pishinën e gjermisë dhe shkollën e skijimit në Brezovicë. Kjo e fundit nuk është funksionalizuar asnjëherë që nga përfundimi i luftës dhe si i tillë objekti që i takon Komunës së Prishtinës është demoluar tërësisht.⁷

Zvarritja e projekteve investuese: Komuna e Prishtinës ka nisur në qershor të vitit 2015 rregullimin e platosë në lagjen "Dardania". Planifikimet kanë qenë që ai projekt të përmbyllet brenda 120 ditëve të punës, por akoma nuk është përfunduar (qershor 2017). Mos përfundimi i punimeve u ka shkaktuar telashe të ndryshme banorëve të ndërtesave në afërsi, veçmas fëmijëve që në disa raste kanë mundur të rrezikohen nga prania e shtyllave të hekurta të lëna në formë të hapur. Ankesa të shumta ka pasur edhe nga bizneset që

⁵ Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti për Komunën e Prishtinës 2015, faqe 22. Burim: <http://bit.ly/2sxH2pP> (hapur më 18.06.2017)

⁶ Instituti GAP. Problemet Kryesore dhe trendet buxhetore të Komunës së Prishtinës 2013. Burim: <http://bit.ly/2t2vETY>

⁷ Problemet nëpër komuna janë identifikuar në bazë të intervistave të drejtpërdrejta me përfaqësues komunal, të partive politike, shoqërisë civile, mediave dhe njohëseve të qeverisjes lokale .



veprimtarinë e ushtrojnë në zonën e quajtur 'nën kurriz' të cilat ankohen për humbje financiare si rezultat i vërshimit të lokaleve të tyre nga uji gjatë të reshurave. Projekt tjetër i zvarritur është ai për konservimin e objektit me të vjetër të Prishtinës "Xhaminë e Gurit" apo e njohur ndryshe si Xhamia e Çarshisë. Punët në restaurim dhe rindërtim kanë filluar më 2011 por janë ndalur më 2013. Aktualisht hapësira e brendshme e kësaj xhamie shfrytëzohet nga delikuentët.

Operimi i taksive ilegalë: Komuna e Prishtinës nuk ka arritur të ndalojë qarkullimin e taksive ilegal. Kjo formë e veprimtarisë ka dëmtuar në masë të madhe kompaninë e trafikut urban e cila e ka të vështirë të sigurojë udhëtarë shkaku i lëvizjes së tyre me taksitë ilegal. Përveç dëmtimit të kompanisë së trafikut urban, të dëmtuar rezultojnë edhe kompanitë e operatoreve privat që janë të licencuar për bartjen e udhëtareve në disa linja të Prishtinës. Komuna nga ana tjetër, gjatë periudhës 2014-2017 ka ndërmarrë shtatë aksione të gjera për ndëshkimin e taksive ilegal me qëllim të largimit të tyre. Rezultatet e aksioneve kanë qenë disa ditore dhe taksitë ilegal janë kthyer serish në linjat e ndryshme. Ata hasen kryesisht në linjën Prishtinë-Fushë Kosovë, Prishtinë-Podujevë dhe brenda qytetit të Prishtinës përkatësisht në relacionet për lagjen "Bregu i Diellit" dhe në relacionin drejt Parkut të Gërmisë.

Shitësit ambulant: Kjo formë e shitjes ose ekspozimit të mallrave vërehet në disa pjesë të qytetit e veçmas në sheshet kryesore të Prishtinës, përgjatë rrugës "Bulevardi i Dëshmoreve", si dhe në lagjen "Ulpiana". Prezenca e shitësve ambulantë pa leje mund të dëmtojë bizneset tjera të ligjshme.

Zhurma gjatë natës: Lokalet hoteliere që funksionojnë në Prishtinë e kanë të lejuar që muzika që dëgjohet jashtë lokalit mund të lëshohet vetëm deri në ora 24:00. Kjo në masë të madhe nuk respektohet duke shkaktuar kështu pakënaqësi për banorët që jetojnë veçmas në qendër të qytetit. Ky problem haset veçmas në rrugën "Rexhep Luci", "Fehmi Agani", në rrugën "Tring Smajli" si dhe në afërsi të rrugës "B".

Mos menaxhimi i hapësirës të zona "Fusha e Pajtimit": Kjo zonë ka rreth 17 hektarë tokë e cila kryesisht shfrytëzohet për hedhjen e mbeturinave inerte. Në vitin 2015, Komuna e Prishtinës ka nisur gjelbërimin e kësaj hapësire por e ka lënë në gjysmë me arsyetimin se hapësira i takon Ndërmarrjes Regjionale të Ujit "Prishtina". Komuna ka larguar qindra kamionë me mbeturina nga kjo hapësirë

më 2014, por dy vite më vonë mbeturinat inerte janë hedhur sërish nga qytetarët.


Ndotja e ajrit: Ky problem shfaqet më së shumti gjatë sezonës së dimrit. Komuna ka vendosur në gjashtë lokacione mjete për matjen e cilësisë së ajrit dhe të gjeturat e këtyre pajisjeve publikohen online. Krahas kësaj, edhe Ambasada Amerikane në Prishtinë ka vendosur një pajisje të tillë.

Mungesa e mirëmbajtjes së ndërtesave kolektive: Pjesa dërmuese e ndërtesave në Prishtinë që janë të ndërtuara para vitit 2000 nuk kanë mirëmbajtje të brendshme. Në shumicën e rasteve mungon ndriçimi i shkalleve, mungojnë anësoret e shkallëve, mungojnë dritaret ose dyert e hyrjes si dhe orët e rrymës janë të dëmtuara duke rrezikuar potencialisht fëmijët. Përveç kësaj në një pjesë të konsiderueshme të këtyre ndërtesave podrumet janë të mbuluara me ujë, ka rrjedhje të kanalizimit dhe mbeturina që kundërmojnë erëra të këqija.

Ekspozimi i mallrave ushqimore jashtë shitoreve: Në të gjitha pjesët e Prishtinës hasen dhjetëra shitore të cilat i ekspozojnë produktet e ndryshme ushqimore edhe jashtë lokalit, përkatësisht në ambient të hapur. Komuna e Prishtinës ka një vendim të shkruar ku ndalohet kjo formë e ekspozimit të mallrave ushqimore. Kjo formë e shitjes së mallrave përveç që rrezikon shëndetin e konsumatorëve, cenon edhe hapësirën e lëvizjes së kalimtarëve , ngase në shumicën e rasteve shfrytëzohen trotuaret për të ekspozuar mallra.

Mungesa e shportave për hedhjen e mbeturinave: Përveç në sheshet kryesore të Prishtinës, dhe përgjatë rrugës “Agim Ramadani”, “Bulevardi i Dëshmoreve”, “Rrugës së UÇK-së” dhe rrugës “Luan Haradinaj” në pjesët tjera të qytetit mungojnë shportat për hedhjen e mbeturinave. Kjo rezulton nga qytetarët me hedhjen e mbeturinave në hapësira publike.

Mos menaxhimi duhur i mbeturinave: Kompania për menaxhimin e mbeturinave në kryeqytet “Pastrimi” bën çdo dy ditë largimin e mbeturinave nga kontejnerët e qytetit. Pjesët periferike dhe fshatrat të cilat nuk mbulohen me kontejner në afërsi të kryeqytetit, mbeturinat largohen nga shtëpitë e tyre një herë në javë. Kjo vlerësohet nga qytetarët si formë e gabuar e menaxhimit, ngase së paku gjatë sezonës të verës do të duhej që mbeturinat të largoheshin dy herë brenda javës për shkak të kundërmimit të tyre.



Mungesa e rregullimit të tregut të gjelbër: Prishtina ka dy tregje, njeri në afërsi të objektit të ish RTP (tani RTK) lagjja “Xhemajl Ibish” dhe njeri në lagjen “Ulpiana”. Tregu i gjelbër në afërsi të RTK-së nuk i plotëson standardet për ekspozimin dhe shitjen e mallit. Që nga pas lufta kanë munguar investimet në këtë hapësirë. Aktualisht me këtë hapësirë menaxhon Agjencia Kosovare e Privatizimit, por komuna do të mund të caktonte ndonjë lokacion të ri të tregut dhe të bënte zhvendosjen e atij tregu nga lokacioni ekzistues.

Problemet nga lumi “Prishtëvka”: Fshatrat Llukat dhe Makovc kanë problem nga lumi Prishtëvka në të cilin derdhen kanalizimet dhe hedhen mbeturina. Lumi kundërmon erë të keqe gjatë verës, ndërsa gjatë dimrit nuk janë të pakta rastet e vërshimeve duke shkaktuar dëme në shtëpitë e banimit.

Mos rregullimi i rrugës “Naim Gashi”: Ruga “Naim Gashi” në zonën e Matiqanit nuk është e asfaltuar. Për me tepër kjo rrugë ka pjerrësi të madhe dhe rrezikohet rënia e automjeteve dhe fëmijëve. Përgjatë kësaj rruge janë rreth 150 shtëpi banimi.

Numri i madh i nxënësve në shkolla

Disa shkolla të Prishtinës përballen me numrin e madh të nxënësve nëpër klasë. Klasat e para fillore në shkollën “Ismajl Qemajli” kanë deri në 45 nxënës në klasë. Ky fenomen është hasur edhe në shkollën e lagjes Kodra e Trimave, përkatësisht në shkollën “Zenel Hajdini” si dhe në disa klasë në shkollën “Pavarësia”. Për veç numrit të madh të nxënësve, objektet shkollore nuk i përmbushin standardet higjienike. Në disa prej tyre veçmas në atë “Ismajl Qemajli” kundërmon era nga tualetet e shkollës.

Fushave që komuna duhet t’u kushtojë vëmendje

Krijimi i hapësirave për parkim të veturave

Në Komunën e Prishtinës në shumë zona urbane ka mungesë të parkingjeve për vetura. Kjo mungesë krijon tollovi të ndryshme dhe nuk kanë qenë edhe të pakta rastet e konflikteve mes banoreve dhe qytetarëve për shkak të parkingjeve të veturave. Komuna do të duhet në katër vitet e ardhshme të konsiderojë këtë fushë në mesin e prioritetëve të saj.

Parandalimi i dëmtimit të hapësirave publike

Komuna ka arritur në vitet e kaluara të ndërtojë në shumicën e lagjeve kënde të lojërave për fëmijë. Pjesa dërrmuese e tyre aktualisht janë jashtë funksionit shkak i dëmtimeve dhe vjedhjeve

nga persona të papërgjegjshëm. Komuna do të duhet të hartonte një plan për riparimin e tyre dhe të gjejë mënyrën e ruajtjes dhe mirëmbajtjes së aseteve publike.

Parandalimi i shfrytëzimit të hapësirave publike për marketing

Pjesa dërmuese e shtyllave elektrike, mureve të objekteve publike dhe hapësira të tjera publike janë të mbuluara me afishe të ndryshme, kryesisht të vendosura nga lokalet hoteliere për të reklamuar shërbimet ose ofertat e tyre të ndryshme. Kjo në masë të madhe po e shëmton pamjen e qytetit. Komuna do të duhet të nis një aksion për largimin e këtyre afisheve dhe ndëshkimin e subjekteve që i kanë vendosur.


Trendet buxhetore në Komunën e Prishtinës (2017)

Komuna e Prishtinës në vitin 2017 ka planifikuar rreth 62 milion euro buxhet.⁸ Përveç të hyrave vetanake (THV) dhe granteve, komuna ka bartur THV nga viti 2016 në vlerë prej 8.7 milion euro, ndërsa në vitin 2013 kjo shumë ka qenë 21.3 milion euro. Duke përjashtuar të hyrat e bartura, krahasuar me vitin 2013, Komuna e Prishtinës ka rënie të buxhetit për rreth 1 milion euro dhe kjo për shkak të uljes së transfereve qeveritare.

Rritja e buxhetit është shënuar në kategorinë e pagave, ndërsa rënie të madhe të buxhetit prej 8.6 milionë euro rezulton në investime kapitale. Kjo është për shkak të rritjes së pagave në administratë publike prej 25% nga ana e Qeverisë së Kosovës në vitin 2014, përkatësisht një rritje të lehtë në shpenzimet tjera rrjedhëse dhe subvencione. Duke përjashtuar të hyrat e bartura, në vitin 2013, Komuna e Prishtinës ka pasur buxhet në total 63 milionë euro, 31 milion (49%) prej tyre kanë shkuar në investime kapitale, ndërsa 22 milionë (35%) në paga dhe meditje. Në 2017, buxheti total është 62 milionë euro, në paga dhe meditje janë ndarë 28 milionë (44%) euro, ndërsa në investime kapitale rreth 23 milionë euro (36%).


⁸ Shih për më shumë platformën buxhetore të Institutit GAP në <http://bit.ly/2rMELbD>

Figura nr.1: Buxheti i komunës së Prishtinës 2017




Në bazë të grafikonit të mëposhtëm shohim se Komuna e Prishtinës vazhdimisht ka pasur rritje të buxhetit në kategorinë e pagave, ndërsa investimet kapitale kanë shënuar rënie. Përveç numrit të rregullt të të punësuarvë, Komuna e Prishtinës ka punësuar 210 persona me kontratë për shërbime të veçanta në vitin 2016.

Figura nr.2: Trendët buxhetore në Prishtinës 2011-2017



Komuna e Prishtinës, gjatë vitit 2016, ka shënuar përparim të dukshëm në rritjen e të hyrave vetanake komunale. Kësisoj, janë realizuar të hyra në vlerë prej 24.2 milionë euro, apo rreth 2.5 milionë euro me shumë se të hyrat e realizuara gjatë vitit 2013.


Figura nr.3: Të hyrat komunale 2013-2016



Rekomandime

Duke u bazuar në problemet kryesore, fushat të cilat kërkojnë vëmendjen e Komunës dhe trendet buxhetore, Instituti GAP rekomandon që qeverisja e komunës e dalë nga zgjedhjet lokale të 2017 të ndërmer këto veprime:

- Komuna duhet të ndajë fond të veçantë për ri-funksionalizimin e shkollës së skijimit në Brezovicë.
- Komuna duhet t'u ndërpresë operatoreve privat kontratat e punës në rastet kur projekti zvarritet për kohë të gjatë.
- Komuna duhet t'i heq shitësit ambulant nga sheshet e qytetit dhe nga rrugët kryesore.
- Komuna duhet të arrijë një marrëveshje me Kompaninë e Ujësjellësit "Prishtina" me qëllim të rregullimi të hapësirës të zona e quajtur "Fusha e Pajtimit".
- Komuna duhet të nisë një aksion ndëshkimi dhe vetëdijesimi ndaj shitoreve të cilat mallrat ushqimore i ekspozojnë jashtë lokaleve.
- Komuna duhet të rrisë në formë të konsiderueshme numrin e shportave në qytet për hedhjen e mbeturinave.

- 
- Komuna, së bashku me kompaninë rajonale “Pastrimi,” duhet të arrijë marrëveshje që heqja e mbeturinave nga lagjet e qytetit të behet dy herë në jave dhe jo një herë gjatë javës siç është praktikë e tanishme.
 - Komuna duhet të zhvendosë tregun e gjelbër nga lokacioni i tanishëm dhe të sigurojë një lokacion dhe kushte të përshtatshme për një treg të kryeqytetit.
 - Komuna duhet të finalizojë nismën për krijimin e këshillave nëpër ndërtesa kolektive me qëllim që këto këshilla të përkujdesen për mirëmbajtjen e ndërtesave kolektive.
 - Komuna duhet përmes inspektoratit të rris aktivitetin gjatë orëve të natës me qëllim të ndëshkimit të subjekteve që konsiderohen shkaktarë të zhurmës.
 - Komuna duhet të ndërmarr aksione ditore për ndëshkimin e operatoreve privat të taksive veçmas në relacionin për Fushë Kosovë, lagjen “Bregu i Diellit” si dhe në relacionin për Podujevë.
 - Komuna duhet t’i ndalojë subjektet që ngjisin fletushka reklamuese në hapësira dhe shtylla publike.
 - Komuna duhet të gjejë zgjidhje për mungesën e parkingjeve në qytet, përmes ndërtimit të parkingjeve nëntokësore apo edhe formave tjera.

Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Ky projekt mbështetet nga:



**National Endowment
for Democracy**

Supporting freedom around the world